



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë



KOLEGJI "BIZNESI"

Nr: 466/20 Data: 03.12.20
PRIZREN

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriazi" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. N.T.P " THESAR" Adresa: V.Qerqilli nr. 51 Suharekë R. e Kosovës, me NRB 811039579.

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe N.T.P "THESAR" - Suharekë, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. N.T.P "THESAR" - Suharekë do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi N.T.P "THESAR" - Suharekë në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparataturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.

3. Kolegji Biznesi do të mbështes, N.T.P "THESAR" me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomis dhe Jurispodencës-sipas nevojave që paraqet N.T.P "THESAR".

Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këti memorandumit është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këti Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5

Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.


Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë


/Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/
Dekan



N.T.P. "THESAR"




/Visar Kuçi /
Drejtor

Nënshkruar në Prishtinë, me datë 03/12/2020